



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA IV

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 86.
Prishtinë, më 29.01.2014 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-01**

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Vesna Mikic, Jelena Bontic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Munguan: Glauk Konjufca dhe Petar Miletic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuese e OSB-së, Lejla Selimi, përfaqësuesi i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković** –kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 03/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, me amandamente të Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 03/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me amandamente të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
- 4. Te Ndryshme.**

Kryesuesja - konstatoi se janë krijuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja – theksoi se në bazë të procedurave parlamentare, komisioni shqyrton projektligjet nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Ajo propozoi të plotësohet rendi i ditës me pikën: shqyrtimi i Projektligjit për Kimikate me raport amendamente të komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedise dhe Planifikim Hapësinor dhe propozimi u miratua unanimisht nga anëtarët e komisionit.

2. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 03/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;

Kryesuesja- paraqet për shqyrtim Projektligjin Nr. 03/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent me Raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin i cili do t'i dërgohet Komisionit FunkSIONAL.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr. 03/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 03/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;

Kryesuesja- paraqet për shqyrtim Projektligjin Nr. 03/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës me Raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin i cili do t'i dërgohet Komisionit FunkSIONAL.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin Nr. 03/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 03/L-197 për Kimikate, me amendamente të Komisionit Funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedise dhe Planifikim Hapësinorë

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin Nr. 03/L-226 për Kimikate me Raport amendamente amendamente të Komisionit Funksional dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- III. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr. 03/L-197 për Kimikate dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Të ndryshme

Lirije Kajtazi - e njoftoi komisionin se sot është takimi i fundit në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim. Ajo shprehu qëndrimin e saj se në komision ka kontribuar dhe ofruar përkrahje profesionale mirëpo për arsye të angazhimeve të saja në dy komisione parlamentare tjera, përfaqësimi i saj do të zëvendësohet me një koleg tjetër.

Kryesuesja – falënderoi kolegen në emër të komisionit për bashkëpunim korrekt dhe mendon se edhe në të ardhmen do të ruhen interesat tona kolegiale.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković